



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT RREGULLOREN PËR TAKSAT
KOMUNALE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, të publikohet Projekt Rregullorja për Taksat Komunale në WebFaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt Rregullore mund të dërgohen me postë elektronike, me shkresa të dërguara Komisionit për hartimin e Projektit të Rregullores për taksat komunale në afat prej 15 dite nga dita e publikimit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

1Nr. 433-7741
Lipjan, më 26.02.2014

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

